



**Përmbledhje e Aktivitetit të Shqipërisë  
në Këshillin e Sigurimit  
(Java 4)**

**24 – 28 janar 2022**

**24 janar 2022**

**Libia:** Këshilli i Sigurimit diskutoi situatën në Libi për të analizuar avancimin në procesin e stabilitetit në Libi, ndërsa vendi përballet me një moment të brishtë, ku abuzimi i vazhdueshëm i imigrantëve, goditja ndaj mbrojtësve të të drejtave të njeriut, ngjallin shqetësim të vecantë. Këshillin e informoi Rosemary DiCarlo, Nën Sekretare e Përgjithshme për çështjet politike dhe ndërtimin e paqes.

Mangësitë në kuadrin ligjor dhe vendimet kontradiktore të gjykatës për kandidatët, ishin ndër arsyet që shkaktuan shtyrjen e zgjedhjeve të 24 dhjetorit 2021. Libia është në një moment delikat dhe të brishtë, për këtë arsye është kritike që të hidhen hapa pozitivë, tha ajo. Bisedimet për tërheqjen e mercenarëve të huaj po përparojnë dhe armëpushimi po mbahet në sajë të vëzhguesve të Misionit Mbështetës të Kombeve të Bashkuara në Libi (UNSMIL). Megjithatë, shqetësimet për të drejtat e njeriut vazhdojnë midis migrantëve, refugjatëve dhe të burgosurve, me gjithë kushtet çnjerëzore që ata durojnë, tha ajo, duke theksuar gjithashtu se pasiguria dhe tensionet kërcënojnë të minojnë përfitimet dhe të rrezikojnë zgjedhjet e suksesshme. Duke cituar fjalët e shumë libianëve, ajo tha se rruga përpara është përmes kutive të votimit dhe jo armës.

Anëtarët e Këshillit ranë dakord se zgjedhjet duhet të mbahen së shpejti për të avancuar përparimin dhe pajtimin kombëtar. Ata nënvizuan nevojën për çarmatim, çmobilizim dhe përpjekje për riintegrim, veçanërisht në dritën e akumulimit dhe rrjedhës së armëve të sofistikuara dhe armëve të paligjshme me origjinë të huaj në rajon. Shumica e anëtarëve përshëndetën përpjekjet e UNSMIL, duke shprehur mbështetjen për një rinovim më të gjatë mandati.

Duke u pajtuar me një vlerësim të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit se zgjedhjet do të jenë fillimi i një epoke të re, Ambasadori Hoxha theksoi se nuk mund të ketë alternativë për mbajtjen e zgjedhjeve të lira, të drejta e besueshme në Libi, duke shtuar se: “Ata që do të tentojnë të pengojnë e mohojnë të drejtën e libianëve për të mbajtur zgjedhje, duhet të mbajnë përgjegjësi”.

*Shënim: Për disa ditë në Këshill u paraqiten dy projekte të ndryshme nga dy vende të përhershme për përtëritjen e pjesshme e afatshkurtër të Misionit në Libi (technical rollover). Përfundimisht është rënë dakord për një variant të konsoliduar i cili do të paraqitet për aprovim me datë 31 janar 2022.*

**Antiterrorizmi:** Zv. Përfaqësuese e Përhershme, znj. Albana Dautllari, zhvilloi një takim me Nën Sekretarin e Përgjithshëm OKB-së për zyrën kundër terrorizmit të OKB-së, Vladimir Voronkov. Takimi shërbeu për të njohur UNOCT me prioritetet e Shqipërisë për çështjen e terrorizmit dhe të çështjeve të lidhura me këtë fenomen si dhe shfrytëzimin e mundësive për bashkëpunim në luftë kundër terrorizmit, rritjen e kapaciteteve teknologjike të vendeve si dhe forcimin e bashkëpunimit në fusha me interes.

**Iraq:** Përmes një deklaratate për shtyp, vendet e Këshillit dënuan në formën më të ashpër sulmin terrorist në Irak ku gjetën vdekjen 11 ushtarë.

## 25 janar 2022

**Mbrojtjen e Civilëve në Konfliktet e Armatosura:** Norvegjia organizoi aktivitetin e dytë shënjujes të presidencës së saj, debati i hapur për Mbrojtjen e Civilëve në Konfliktet e Armatosura: Luftërat në Qytete - Mbrojtja e Civilëve në mjediset urbane, i cili u kryesua nga kryeministri norvegjez Jonas Gahr Støre. Takimi synonte të theksonte efektet shkatërruese të luftës në mjediset urbane dhe të bënte thirrje për të evituar konfliktin në zonat urbane dhe njëkohësisht për të gjetuar mjete efektive për t'i dhënë fund pandëshkueshmërisë dhe për të përmirësuar reagimin humanitar. Folësit e shumtë sugjeruan mënyra për mbrojtjen më të mirë të civilëve, ndërsa debati vuri në qendër sulmet në zonat e populluara të Jemenit, Ukrainës etj.

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, z. António Guterres, tha se përgjegjësia për shkelje të rënda është thelbësore, në një kohë kur 50 milionë njerëz aktualisht përballen me pasojat e tmerrshme të luftës urbane. Kur armët shpërthyese përdoren në qytete, 90 për qind e të prekurve janë civilë, tha ai, duke u bërë thirrje vendeve anëtare të demonstrojnë vullnetin politik për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet e dyshuara të luftës. Në debat morën pjesë më shumë se 50 folës, disa nga shtete apo rajone të prekura nga konflikti. Ata ndanë idetë e tyre se si të pakësohet dëmi ndaj civilëve në situatat e luftës urbane.

Ambasadori Hoxha vuri në dukje se 50 milionë civilë në mbarë botën janë prekur sot nga konfliktet e armatosura në mjediset urbane, duke përmenduar pasojat dramatike në Afganistan, Siri, Jemen, Libi, Republikën e Afrikës Qëndrore, Mozambik, Somali dhe Ukrainë. Ai iu beri thirrje shteteve, si edhe të gjitha palëve në konfliktin e armatosur, që të sigurojnë respektimin e ligjit ndërkombëtar humanitar dhe mbrojtjen e civilëve në mjediset urbane, të anulojnë, si çështje prioritare, përdorimin e armëve shpërthyese në zonat e populluara urbane dhe të ndërmarrin masa zbutëse

për të reduktuar rrezikun pasues të dëmtimit të civilëve. Duke u kërkuar të gjitha shteteve të kërkojnë dhe të arrijnë konsensus mbi masat për të parandaluar dhe zgjidhur konfliktet e armatosura si mënyra më e mirë për të mbrojtur civilët, Ambasadori Hoxha theksoi se anëtarët e Këshillit, nuk duhet të lejojnë që dallimet politike të minojnë veprimet kolektive për të mbrojtur civilët. Të gjitha shtetet anëtare, duhet të mbështesin Kombet e Bashkuara dhe aktorët e tjerë për të mbrojtur civilët, duke përfshirë mjediset urbane, gjithmonë të sigurojnë përgjegjësi për shkelje të rënda dhe të refuzojnë mosndëshkimin.

*Shënim: Një deklaratë Presidenciale (PRST) është duke u ngociuar mes vendeve anëtare.*

### 26 janar 2022

**Afganistani-UNAMA:** Këshilli i Sigurimit diskutoi situatën e rëndë në të cilën ndodhet Afganistani. Takimi i drejtua nga Kryeministri i Norvegjisë.

Sekretari i Përgjithshëm, Guterres, përshkroi një vend në prag të kolapsit, mes një tkurrjeje prej 30 për qind të produktit të brendshëm bruto (PBB). "Afganistani është i një ferr i acartë" tha ai, duke kujtuar vështirësitë e mëdha për popullsinë nga dimri i ashpër. Ai kërkoi që të sigurohen burime për të parandaluar zhvillimin e mëtejshëm të vendit. Ai u bëri thirrje shteteve anëtare të mbështesin Kornizën Tranzitore të Angazhimit për Afganistanin.

Mahbouba Seraj, Drejtore Ekzekutive e Qendrës për Zhvillimin e Aftësive të Grave Afgane, iu adresua anëtarëve të Këshillit se "Ju keni një përgjegjësi të jashtëzakonshme për të mbajtur premtimet që na keni bërë neve, grave të Afganistanit ndër vite." Duke përshkruar se si talebanët, në më pak se gjashtë muaj minuan të drejtat e fituara me vështirësi për gratë dhe vajzat gjatë dy dekadave, ajo tha se 15 anëtarët e KS, Kombet e Bashkuara dhe komuniteti ndërkombëtar, kanë për detyrë të marrin përgjegjësitë e tyre. "Shpresoj se anëtarët e këtij organi të nderuar dhe komuniteti ndërkombëtar më gjerësisht, do të fillojnë të na marrin seriozisht," tha ajo, duke i kërkuar Këshillit "të zgjedhë të punojë ndryshe", duke siguruar që gratë afgane të jenë realisht pjesë e së ardhmes së Afganistanit. Deborah Lyons, Përfaqësuesja Speciale e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Shefja e UNAMA-s, u bëri jehonë me detaje shtesë deklarimeve të SP, duke theksuar se Kombet e Bashkuara janë "të pozicionuara mirë" për të vazhduar mbështetjen e popullit afgan, duke vepruar si një mundësues i të tjerëve që janë të gatshëm të ofrojnë mbështetje dhe duke u angazhuar me autoritetet de fakto.

Vendet anëtare të Këshillit të Sigurimit u bënë thirrje talebanëve të trajtojnë shqetësimet masive për sigurinë, ekonomine dhe të respektojnë të drejtat e grave. Në tërësi, vendet e Këshillit u shprehën se është koha që talebanët të shfrytëzojnë të gjitha mundësitë për popullin e Afganistanit dhe të demonstrojnë përkushtim të vërtetë për të qenë pjesë e komunitetit global.

Ambasadori Hoxha, duke vënë në dukje se "çdo tregues është me të kuqe" në Afganistan, tha se nuk është e lehtë të gjesh një dritë shprese për shkak të një sërë çështjesh, situata e rëndë humanitare, perspektivat e zymta ekonomike, kërcënimet serioze ndaj të drejtave të grave dhe

vajzave si dhe rreziku i terrorizmit. Duke theksuar se Talebanet nuk u janë përgjigjur thirrjeve për një qeveri gjithëpërfshirëse, ai nënvizoi se vetëm një zgjidhje politike gjithëpërfshirëse, e negociuar, ofron një të ardhme të qëndrueshme për të gjithë popullin afgan dhe përshëndeti bisedimet e vazhdueshme në Oslo për këtë qëllim. Ai i kërkoi Këshillit t'i jepte prioritet të qartë përfshirjes së grave në proceset që formojnë të ardhmen e tyre. Ai u kërkoi talebanëve të lehtësojnë aksesin e plotë, të sigurt dhe të papenguar në organizatat humanitare dhe në të gjithë personelin e tyre, pavarësisht nga gjinia. Më tej, ai nënvizoi nevojën për të respektuar të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, duke përfshirë lirinë e shtypit në Afganistan, duke shtuar: “Të jetosh në siguri, siguri dhe dinjitet për të gjithë, duke përfshirë gratë dhe vajzat, të rinjtë, fëmijët dhe pakicat, nuk duhet të jetë një ëndërr por realitet.” Këshilli duhet të qëndrojë i vendosur në favor të të drejtave të grave dhe vajzave, duke përfshirë aksesin e plotë dhe të barabartë në arsim dhe lëvizjen e lirë. "Këto nuk janë një dhuratë, ato janë të drejta universale," theksoi ai. Talebanët duhet të ndërpresin pa mëdyshje lidhjet me të gjitha organizatat terroriste ndërkombëtare.

**Syria (Political):** Këshilli zhvilloi takimin e përmuajshëm të analizës së situatës politike në Siri. I Dërguari Special i SP, Pedersen, informoi Këshillin duke theksuar vështirësitë që paraqet situata për iniciimin e një procesi politik të njëmendtë dhe kërkoi ndihmën e vendeve të Këshillit, në mënyrë të vecantë palëve të përfshira në Siri. Duke kërkuar angazhimin e palëve ai theksoi pa detaje se të gjithë kanë dicka për të vënë në tavolinë.

Ashti si edhe në aspekte të tjera të analizës së Këshillit mbi situatën në Siri (humanitare, armët kimike) vendet anëtarë të këshillit kanë qendrimë të ndryshme cka nuk lejon angazhimin e një procesi të njëmendtë.

Ambasadori Hoxha thksoi se “ngërçi aktual nuk është diçka mbi të cilën Këshilli mund të ndërtohet për të avancuar. Ngërçi vetëm con në thellimin e vuajtjeve të popullit sirian, dhunën e pandërprerë kundër civilëve, urinë, varfërinë ekstreme, frikën, ankthin, terrorin dhe shpartallimin e shpresës për një të ardhme më të ndritshme për sirianët e zakonshëm. Përjetësimi i kësaj status quo-je është i paqëndrueshëm, në kundërshtim me atë që përfaqëson ky Këshill. Ne duhet të ndezim shpresën për një të ardhme më të mirë për popullin sirian. Ai theksoi nevojën e llogaridhënies si komponent i rëndësishëm për të avancuar drejt të ardhmes. “Përgjegjësia dhe drejtësia për viktimat janë jetike për një tranzicion politik kuptimplotë që çon në një Siri demokratike, një shtet që respekton të drejtat themelore të qytetarëve të saj dhe jeton në paqe me fqinjët e saj”, theksoi ai.

**Japonia:** Ambasadori Hoxha pati një drekë pune me Ambasadorin e Japonisë në OKB ku u bisedua për bashëpunimin dy e shumëpalësh përfshirë në kuadër të KS.

## 27 janar 2022

**UNFICYP:** Këshilli i Sigurimit zgjati mandatin e Forcave Paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara në Qipro (UNFICYP) për gjashtë muaj, deri më 31 korrik, duke miratuar njëzëri Rezolutën 2618 (2022), e cila shpreh shqetësim serioz për disa çështje, përfshirë këtu shkeljet e vazhdueshme të status quo-së ushtarake përgjatë vijave të armëpushimit. Këshilli u bëri thirrje udhëheqësve të dy

komuniteteve qipriotë, si edhe të gjitha palëve të përfshira, që të përmbahen nga çdo veprim dhe retorikë që mund të dëmtojë zgjidhjen proces dhe mund të rrisë tensionet në ishull.

**UNRCCA/Azia Qendrore:** Këshilli zhvilloi konsultime të mbyllura me vendet anëtare mbi aktivitetin e Qendrës Rajonale të Kombeve të Bashkuara për Diplomacinë Parandaluese në Azinë Qendrore, për periudhën gjashtëmujore duke filluar nga korriku 2021. Diapazoni i punës dhe mandatit të UNRCCA është shumë i gjerë. Ai shtrihet nga trajtimi i çështjeve politike dhe ndërveprimi midis shteteve, deri tek bashkëpunimi rajonal mes vendeve të Azisë Qendrore, por edhe të gjitha tematikat që shoqërojnë zhvillimet në këto vende, përfshirë dhe kërcënimet nga jashtë, si në kontekstin e situatës në Afganistan. Drejtuesja e zyrës, znj. Gherman u përqendrua tek sfidat me të cilat është përballur Qendra gjatë kësaj periudhe, dhe ndër të cilat ajo përmendi zhvillimet në Afganistan dhe situatën e krijuar në raport me rajonin e Azisë Qendrore, më i afërti gjeografikisht me këtë vend.

Zv/Përfaqësuesja e Përhershme, znj. Dautllari, ndër të tjera e vuri theksin tek roli që diplomacia parandaluese luan për kufizimin e konflikteve sot në botë, për të cilën Shqipëria është mbështetëse e pakufishme. Ajo nënvizoi identifikimin e hershëm të sinjaleve paralajmëruese për konflikteve të mundshme dhe veprimin e shpejtë përpara fillimit dhe përshkallëzimit të konflikteve. Znj. Dautllari nënvizoi se respekti për të drejtat e njeriut, ka qenë një instrument në parandalimin e konflikteve, ashtu si edhe pjesëmarrja e plotë në vendimmarrje e interlokutorëve kyç, përfshirë gratë dhe të rinjtë. Duke vendosur në plan të parë rolin e të rinjve, ajo solli shembullin pozitiv të RYCO, Organizata Rajonale e Qendrës Rinore me seli në Tiranë, ku bëjnë pjesë 6 vende të BP, e cila funksionon në frymën e pajtimit dhe bashkëpunimit nëpërmjet disa programeve të shkëmbimit rinore. Gjithashtu, znj. Dautllari përmendi rolin vital që luajnë burimet energjetike dhe ujore për rajonin e Azisë Qendrore, si një burim i mundshëm konfliktesh ndërshtetërore.

Anëtarët e KS përgjithësisht e përgëzuan UNRCCA për punën e kryer, sidomos për angazhimin në bashkëpunimin me UNAMA.

**Siria (Humanitare):** Koordinatorin i Ndhmës Emergjente të OKB-së, Griffiths dhe Jan Egeland, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit Norvegjez të Refugjatëve, përshkruan situatën humanitare në Siri që vazhdon të përkeqësohet. Ndërsa konflikti në Siri hyn në dekadën e tij të dytë, as minimumi i ndihmës së mjaftueshme të mbrojtjes civile dhe aksesit në shërbimet bazë sociale nuk po sigurohet për popullin e atij vendi. “Dështimi çdo vit nuk mund të jetë strategjia jonë” theksuan ata. Griffiths theksoi kushtet e pasigurta në kampet e refugjatëve, që për shkak të dhunës dhe kushteve të dimrit, po përkeqësojnë vuajtjet e të zhvendosurve. Ai vuri në dukje se burimet financiare të tanishme mund të ndihmojë vetëm për të mbuluar gjysmën e mbi 4 milionë njerëzve në nevojë në të gjithë Sirinë. “Këshilli nuk ka mbaruar punë për popullin sirian.” Duke vënë në dukje se rreth 3 milionë civilë jetojnë në zonat e kontrolluara nga opozita, ai u bëri thirrje të gjitha palëve me ndikim në grupet e armatosura të opozitës që të rinovojnë angazhimet e tyre me ndërmjetësit e Kombeve të Bashkuara për të arritur një zgjidhje të negociuar dhe për të parandaluar një gjakderdhje të mundshme.

Anëtarët e Këshillit shprehën shqetësimin për ndërlidhjen e krizave që përkeqësuan vuajtjet e popullit sirian, 90 për qind e të cilit jetojnë në varfëri, dhe shprehën alarmin për shpërthimin e dhunës që përfshin ISIL /Da'esh në verilindje. Ndërsa vendet anëtare ishin të bashkuara për të nënvizuar nevojën për të përmbushur nevojat humanitare marramendëse në mes të kushteve të vështira të dimrit, u shfaqën ndarje rreth mekanizmave ndërkufitar dhe vendosjes së sanksioneve ndaj Sirisë.

Ambasadori Hoxha tërhoqi vëmendjen për kushtet e rënda humanitare, ku 90 për qind e sirianëve jetojnë në varfëri dhe shumë prej tyre përballen me zhvendosje, dhunë dhe kriza të shumta, duke nënvizuar se ndihma për shpëtimin e jetëve është një prioritet. Por ndihma duhet të shkojë përtej sigurimit të ushqimit dhe ilaçeve, pasi sirianët kanë nevojë për arsim, liri dhe shpresë. Këshilli shpesh ka treguar se mund të ndërmarrë veprime dhe të ndikojë në ndryshim, tha ai, duke i kërkuar organit 15 anëtarësh të hapë pika të tjera kufitare për të lejuar që punonjësit e ndihmës të arrijnë miliona njerëz që kërkojnë ndihmë bazë. Të gjitha shtetet duhet të respektojnë ligjin ndërkombëtar humanitar dhe masat e mbrojtjes civile, tha ai, duke u kërkuar gjithashtu atyre të sigurojnë kalimin e shpejtë dhe të sigurt të dërgesave të ndihmave.

**Siria (terrorism):** Pas sulmit të bërë nga një celulë e fjetur e ISIS ndaj një burgu me mbi 3 mijë ish-luftëtarë të huaj, përfshi gra e fëmijë, në Veri Lindje të Sirisë, i cili ruhet nga forcat kurde, Rusia kërkoi një takim jashtë agendës së Këshillit.

Shefi i Zyrës së Kombeve të Bashkuara për luftën kundër terrorizmit, Nën Sekretari i Përgjithshëm, Voronkov, nënvizoi rëndësinë e zgjidhjes së shpejtë të problemeve kronike, të tilla si ndalimi i gjatë i individëve, përfshirë fëmijët, pa akuza dhe nevojën urgjente për riatdhesim në vendet e tyre të origjinës. Ai i kërkoi Këshillit të adresojë kushtet e rënda të të burgosurve në Al-Hol, Al-Roj dhe qendra të tjera të paraburgimit në verilindje, ku shumica janë gra dhe fëmijë. Sulmi në burg, së bashku me një tjetër të nisur 11 orë më vonë në Irak, i cili vrau 11 ushtarë, nxjerr në pah dy shqetësime urgjente, tha ai: sulmet nuk janë incidente të izoluara dhe kërkojnë një përgjigje të shpejtë dhe të bashkërenduar, tha ai.

Anëtarët e Këshillit dënuan ashpër dhunën e vazhdueshme në verilindje të Sirisë dhe mbështetën një pjesë e madhe prej tyre bënë thirrje për të shpejtuar riatdhesimin e luftëtarëve të huaj dhe për të avancuar procesin e drejtësisë. Disa vende dhanë shembuj se si vendet e tyre janë prekur nga terrorizmi dhe theksuan kontributin e tyre në luftën kundër grupeve terroriste. Të tjerë bënë thirrje për mbështetjen e Kornizës Globale për Mbështetjen e Kombeve të Bashkuara për të kthyerit kombëtarë të vendeve të treta në Siri/Irak, e nisur në vitin 2021.

Ambasadori Hoxha iu bashkua vendeve të tjera në dënimin e akteve të terrorizmit në Siri dhe më gjerë. Autorët duhet të sillen para drejtësisë, tha ai, dhe bëri thirrje që të përdoren të gjitha mjetet për të mposhtur terrorizmin. Duke theksuar se vetëm mjetet ushtarake janë të pamjaftueshme, ai nënvizoi nevojën për të trajtuar shkaqet rrënjësore që çojnë rininë drejt radikalizimit. Ai gjithashtu theksoi përpjekjet që po bëjnë Shqipëria për të riatdhesuar gratë dhe fëmijët duke sjellë shëmbullin

riatdhesimit të 24 grave dhe fëmijë shqiptarë të kapur në konfliktin në verilindje të Sirisë që prej vitit 2020, duke u dhënë mundësinë për një jetë të re.

**Ethiopia:** Me iniciativën e Britanisë së Madhe dhe me kërkesë të përbashkët të gjashtë vendeve të Këshilit (Shqipëri, Francë, Irlandë, Norvegji, UK dhe USA), më 28 janar u zhvillua në pikën të tjera (AoB) mbi situatën në Ethiopi, i përqendruar kryesisht në situatën humanitare në vend. Gjatë takimit informoi Martin Griffiths, Zv/Sekretar i Përgjithshëm për Çështjet Humanitare dhe Koordinator i Ndhmës Emergjente.

Këshilli ka diskutuar thuajse cdo muaj në të njëjtën formë mbi Ethiopinë pa qenë në gjendje të bëjë më shumë e të mbajë qendrimet konkrete më shumë për shkak të qendrimeve të ndryshme.

Ambasadori Hoxha theksoi se “në këtë luftë të përgjakshme civile, është e pamohueshme që palët ndajnë përgjegjësinë për vuajtjet me të cilat përballet populli etiopian, veçanërisht në Tigray. Ndërpreja e menjëhershme e armiqësive është çelësi për t'i dhënë fund kësaj lufte katastrofike, ndërsa në të njëjtën kohë duhet të fillojë një dialog politik gjithëpërfshirës kuptimplotë midis të gjithë aktorëve të përfshirë në konflikt. Shqipëria u kërkon të gjitha palëve të lejojnë akses të plotë dhe të papenguar humanitar në zonat e konfliktit dhe të mos ndërhyjnë në operacionet dhe shpërndarjen e ndihmave”. Ai e cilësoi situatën e përgjithshme në Tigray thjesht alarmante. “Shqipëria është seriozisht e shqetësuar për situatën e të drejtave të njeriut dhe dhunën ndëretnike të cilat janë përkeqësuar muajt e fundit. Ne dënojmë dhe dënojmë të gjitha praktikatat e trajtimeve çnjerëzore nga të gjitha palët në konflikt”, theksoi si.

**Libia:** Ambasadori Hoxha priti në takim Ambasadorin e Libisë në OKB me të cilin bisedoi gjerësisht mbi situatën dhe zhvillimet në vend, përfshirë në dritën e diskutimeve në Këshill dhe ecurisë së përtëritjes së mandatit të Misionit të OKB-së atje (UNSMIL).

## 28 janar 2022

**Myanmar:** Me iniciativën e Britanisë së Madhe dhe me kërkesë të përbashkët të gjashtë vendeve të Këshilit (Shqipëri, Francë, Irlandë, Norvegji, UK dhe USA), më 28 janar u zhvillua një takim i mbyllur i KS mbi situatën në Mianmar. Për shkak të mungesës së dakordësisë, deri tani Këshili nuk ka qenë në gjendje të zhvillojë një takim të hapur. Në takim informoi Zv/KM dhe MPJ i Kamboxhias, z. Prak Sokhonn, në cilësinë e të Dërguarit të Posaçëm të ASEAN për Mianmarin, znj. Noeleen Heyzer, e Dërguara e Posaçme e SP të OKB për Mianmarin, si edhe z. Ramesh Rajasingham, Zv/Koordinator i Ndhmave të Emergjencës – OCHA. Përkeqësimi i situatës humanitare, perspektiva e përshkallëzimit, shkelja e të drejtave të njeriut si dhe mungesë e perspektivës Ambasadori Hoxha bëri thirrje për lirimin e të burgosurve politikë, duke filluar nga Këshilltarja e Shtetit Aung San Suu Kyi dhe Presidenti Win Myint (kjo thirrje më pas u përmend edhe nga Meksika, Franca, UK, SHBA dhe Franca). Situata humanitare e përkeqësuar, kërkon që ekipet humanitare të kenë akses në të gjithë vendin. Ai theksoi se duhet të veprojmë tani të bashkuar, ndërkohë që populli i Mianmarit po na kërkon ndihmë.

*Shënim: për këtë çështje vendet e Këshillit janë duke rënë dakord për një deklaratë shtypi të propozuar nga UK.*

**Libia:** Sic ishte parashikuar, Misioni organizoi takimin e parë të E10 në nivel eksperti mbi situatën në Libi. Për të informuar takimin Misioni mundësi praninë e Ambasadorit të Libisë në OKB si dhe një përfaqësues të DPPA.

#